



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“ELEKTROTEKNIKË”

Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

E-II-21

Tiranë 2021

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Elektroteknikë			
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	Kodi E-II-21
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional në drejtimin mësimor “ Elektroteknikë ”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim bazë në punimet elektrike dhe elektronike, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në drejtimin mësimor “Elektroteknikë” të nivelit II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë e tyre. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional drejtimi mësimor “Elektroteknikë”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajis individin Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të nivelit të punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në veprimtari të profesionale që lidhen me instalime, montime, mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta të pajisjeve dhe rrjetit të transmetimit në fushën e elektroteknikës dhe elektronikës. Ai/Ajo mund të ushtrojë veprimtari profesionale në njësi të shitjeve dhe blerjeve të materialeve dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe në veprimtari të tjera që kanë lidhje me to.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional drejtimi mësimor “Elektroteknikë”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin III ose të IV të kualifikimit profesional (një ose dy vjeçar), në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi. Me arsimim të mëtejshëm në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	E-I-10, E-II-17			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin mësimor “Elektroteknikë” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës

- Të shpjegojë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Të përshkruajë mënyrën e organizimit të vendit të punës për realizimin e një instalimi të thjeshtë elektrik dhe për punime të thjeshta elektroteknike;
- Të përshkruajë rëndësinë e vendosjes së prioriteteve në punën e vet;
- Të dallojë materialet e nevojshme për realizimin e proceseve të punës;
- Të listojë veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdoren në procese të ndryshme pune për punime të ndryshme në fushën e elektroteknikës;
- Të listojë aparatet matës që përdoren për matje, si dhe gjatë diagnostikimit dhe riparimit të pajisjeve të ndryshme elektrike duke përshkruar veçoritë dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të thjeshta së materialeve, mjeteve të punës dhe kohës së punës;
- Të përshkruajë mënyrën e mirëmbajtjes së veglave të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e sistemit të vendit të punës gjatë dhe mbas mbarimit të punës;

Vizatimi dhe dokumentacioni teknik

- Të përshkruajë standardet e vizatimit të thjeshtë teknik dhe të skicimit;
- Të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet për skicat dhe vizatimet teknike të thjeshta;
- Të lexojë vizatime të thjeshta; skema elektrike, elektronike, mekanike dhe hidraulike të ndërtimit, plane dhe harta topografike;
- Të dallojë shkallët e paraqitjes së objekteve në vizatim teknik;
- Të përshkruajë paraqitjen me prerje të objekteve të thjeshtë në vizatime dhe skica;
- Të dallojë paraqitjet e detaleve të filetuara në vizatimin teknik;
- Të përshkruajë skica dhe vizatime të detaleve të thjeshta;
- Të përshkruajë përparësitë e të vizatuarit me kompjuter dhe programet përkatëse;
- Të listojë llojet e dokumentacionit teknik duke përshkruar përdorimet e tyre;

Materialet dhe vetitë e tyre

- Të listojë materialet sipas vetive dhe përdorimit të tyre;
- Të dallojë materialet përcjellëse, gjysmëpërcjellës dhe izoluese;
- Të dallojë llojet e pjesëve të parafabrikuara elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë përcjellësit dhe kabllot sipas seksionit dhe ngjyrave;
- Të listojë llojet e tubove, kanalave dhe kutive sipas përdorimeve të tyre;

- Të listojë pajisjet mbrojtëse të një instalimi të thjeshtë;
- Të listojë llojet e aksesorëve sipas përdorimeve të tyre;
- Të tregojë ndërtimin dhe funksionimin e pajisjeve të ndriçimit;
- Të përshkruajë karakteristikat e ndriçimit;

Montime dhe instalime të thjeshta elektrike dhe elektronike

- Të përshkruajë teknikat e hapjes së kanaleve dhe foleve në mure dhe dysheme për vendosjen e tubove dhe mjetet përkatëse;
- Të përshkruajë teknikat e prerjes, fiksimit, shtrirjes dhe tërheqjes të përcjellësve/kabllove;
- Të përshkruajë teknikat e prerjes dhe fiksimit të tubove, montimin e kanalave dhe aksesorët e duhur;
- Të listojë burimet e energjisë elektrike;
- Të përshkruajë skemat e rrjetave shpërndarëse të tensionit të ulët;
- Të dallojë rrjetin e duhur elektrik sipas llojit të konsumatorit dhe nivelit të tensionit;
- Të përshkruajë elementet për ndërtimin e rrjetave ajrore dhe kabllorë;
- Të përshkruajë mënyrën e vendosjes së kabllorëve në tokë;
- Të përshkruajë skemat e rrjetave shpërndarëse të linjave të telekomunikacionit dhe sinjaleve video;
- Të përshkruajë elementet për ndërtimin e rrjetave të telekomunikacionit dhe sinjaleve video;

Bazat e elektroteknikës

- Të përshkruajë ligjet themelore të elektroteknikës dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë madhësitë kryesore që karakterizojnë rrymën e vazhduar dhe alternative;
- Të shpjegojë qarqet e thjeshta elektrike të rrymës së vazhduar dhe alternative;
- Të shpjegojë qarqet e përbëra të rrymës alternative;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes të parametrave në qarqet e thjeshta dhe të përbëra të rrymës së vazhduar dhe alternative;
- Të shpjegojë relacionin ndërmjet rrymave dhe tensioneve për mënyra të ndryshme lidhjeje yll/trekëndësh dhe anasjelltas;
- Të përshkruajë fushën elektrike dhe magnetike, si dhe madhësitë që e karakterizojnë atë;
- Të shpjegojë mënyrat e prodhimit të rrymës alternative një dhe tre fazore;
- Të përshkruajë dukurinë e rezonancës së tensioneve dhe rrymave;

Bazat e elektronikës

- Të përshkruajë vetitë kryesore të elementeve gjysmëpërcjellës sipas karakteristikave të tyre;
- Të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe karakteristikën V-A të gjysmëpërcjellësve;
- Të tregojë funksionimin dhe veçoritë e skemave me gjysmëpërcjellës;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së parametrave bazë të skemave me gjysmëpërcjellës;
- Të përshkruajë veçoritë e lidhjeve të kundërta në skema;
- Të përshkruajë ndërtimin, veçoritë e përforcuesve operacional;
- Të tregojë funksionimin dhe veçoritë e skemave me përforcues (operacionalë me transistor dhe përforcuesit e fuqisë, etj.);
- Të përshkruajë parimin e punës së gjeneratorëve elektronik;
- Të përshkruajë parimin e punës të një burimi fuqie;

- Të dallojë madhësitë analoge dhe digjitale;
- Të listojë sisteme të ndryshme numerike;
- Të përshkruajë parimin e punës së portave logjike me algjibrën binare;
- Të përshkruajë llojet, veçoritë dhe ndërtimin e linjave të transmetimit;
- Të përshkruajë procesin e përhapjes së valëve në hapësirë;
- Të listojë llojet e ndryshme të rrjetave kompjuterike;

Matje dhe aparatet matës në elektroteknikë dhe elektronikë

- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së gabimeve që bëhen gjatë matjeve elektrike;
- Të listojë aparatet që përdoren për të bërë matje të ndryshme;
- Të përshkruajë metodat e matjeve elektrike dhe elektronike dhe dallimet midis tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e matjes të parametrave të qarqeve të rrymës alternative;
- Të përshkruajë matjen e madhësive jo-elektrike me metoda elektrike;

Njohuritë bazë të makinave elektrike

- Të klasifikojë makinat elektrike sipas llojit;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e transformatorit;
- Të shpjegojë parimin e punës, veçoritë dhe dallimet e makinave elektrike të rrymës së vazhduar;
- Të përshkruajë parimin e punës, veçoritë dhe dallimet e makinave të rrymës alternative dhe ndryshimet midis tyre;
- Të përshkruajë skemën e hapur të një pështjellë të thjeshtë të makinës së rrymës alternative;
- Të listojë elementet kryesore sipas radhës së çmontim-montimit të makinave elektrike;
- Të dallojë veçoritë e makinave speciale të rrymës alternative;
- Të shpjegojë skema të thjeshta të komandimit të motorit elektrik;

Mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta elektrike dhe elektronike

- Të përshkruajë rëndësinë e mirëmbajtjes së pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike.
- Të listojë llojet e mjeteve të përshtatshme për pastrimin dhe mirëmbajtjen periodike të pajisjeve elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë teknikat e mirëmbajtjes së pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë teknikat e mirëmbajtjes së rrjeteve dhe elementëve përbërës;
- Të listojë defektet kryesore të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të listojë llojet e mjeteve të përshtatshme për riparimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë teknikat e riparimit të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë teknikat e riparimit të rrjeteve dhe elementëve përbërës;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit fizik të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë radhën e çmontimit dhe montimit të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë teknikat e riparimit dhe të zëvendësimit të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;

- Të përshkruajë llojet e testimeve para, gjatë dhe mbas riparimit të pajisjeve të thjeshta elektrike;
- Të përshkruajë rëndësinë e raportimit për procesin e mirëmbajtjeve dhe riparimeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;

Sigurimi teknik e mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të listojë pajisjet mbrojtëse individuale dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së rregullores së brendshme të biznesit;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë punimeve të ndryshme në fushën e elektroteknikës;
- Të tregojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë dhe mjetet që përdoren;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të interpretojë sinjalistikën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit nga ndikimi i fushave magnetike dhe elektrostatike dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes pastër të mjedisit të punës;

Rezultatet e të nxënit në:

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin mësimor “Elektroteknikë” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi do të përvetësojë aftësitë profesionale të mëposhtme:

Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës

- Të organizojë vendin e punës për realizimin e instalimeve të thjeshta elektrike;
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punime të ndryshme elektroteknike;
- Të mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës;
- Të sistemojë veglat e punës dhe materialet e punës para, gjatë dhe pas përfundimit të punës;
- Të kryejë manovrimet e paracaktuar për të parandaluar efektet e padëshiruara ndaj sistemeve/pjesëve që ndikohen nga puna e tij;
- Të koordinojë punën me persona të tjerë që punojnë në të njëjtin ambient;
- Të zbatojë standardet e punimeve elektroteknike;
- Të raportojë për punimet e kryera;

Vizatimi dhe dokumentacioni teknik

- Të zbatojë standardet e vizatimit teknik dhe të skicimit;

- Të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet për skicat dhe vizatimet teknike të thjeshta;
- Të vizatojë skema të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të lexojë skema të thjeshta elektrike, elektronike, mekanike etj.;
- Të zbatojë rregullat e vendosjes së përmasave në skica e vizatime të thjeshta;
- Të vizatojë paraqitjen me prerje të objekteve të thjeshtë në vizatime dhe skica;
- Të skicojë detale të thjeshta;
- Të hartojë një projekt të thjesht ndriçimi elektrik për objekte të mbyllura;

Materialet dhe vetitë e tyre

- Të përzgjedhë materialet sipas vetive të tyre dhe proceseve të punës;
- Të përzgjedhë materialet përcjellëse, gjysmëpërcjellëse dhe izoluese sipas skemës;
- Të përzgjedhë llojet e pjesëve të parafabrikuara elektrike dhe elektronikë;
- Të përzgjedhë përcjellësit dhe kabllot sipas seksionit dhe ngjyrave;
- Të përzgjedhë llojet e tubove, kanalave dhe kutive, sipas përdorimeve të tyre;
- Të përzgjedhë pajisjet mbrojtëse të një instalimi të thjeshtë;
- Të përzgjedhë llojet e aksesorëve sipas përdorimeve të tyre;
- Të përzgjedhë pajisjet e ndriçimit sipas skedës teknike dhe projektit;

Montime dhe instalime të thjeshta elektrike dhe elektronike

- Të lexojë skemat e dhëna të instalimit;
- Të përzgjedhë veglat e punës për realizimin e montimeve dhe instalimeve sipas procesit të punës;
- Të kryejë kuotimet dhe matjet për hapjen e kanaleve dhe foleve në mure dhe/ose dysheme
- Të kryejë hapjen e kanaleve dhe foleve në mure dhe dysheme për vendosjen e tubove dhe aksesorëve përkatëse;
- Të kryejë matje, prerje dhe axhustime në punime të thjeshta elektrike duke përdorur pajisjet përkatëse;
- Të kryejë fiksimin e tubove, montimin e kanalave dhe aksesorëve të duhur;
- Të kryejë matjen dhe prerjen e përcjellësve/kabllove;
- Të realizojë shtrirjen, fiksimin dhe tërheqjen e përcjellësve/kabllove;
- Të montojë elemente të një skeme të thjeshtë elektrike;
- Të skicojë skemat e rrjetave shpërndarëse të tensionit të ulët;
- Të përzgjedhë elementet e rrjetit elektrik sipas llojit të konsumatorit dhe nivelit të tensionit;
- Të përzgjedhë elementet për ndërtimin e rrjetave ajrore dhe kabllorë;
- Të kryejë hapjen e kanaleve të kabllorë në tokë;
- Të kryejë shtrirjen/vendosjen e kabllorë në tokë sipas standardit dhe kushteve teknike;
- Të ndihmojë në montimin e elementeve të rrjetave ajrore dhe kabllorë;
- Të skicojë skemat e rrjetave shpërndarëse të linjave të telekomunikacionit dhe sinjaleve video;
- Të përzgjedhë elementet për ndërtimin e rrjetave të telekomunikacionit dhe sinjaleve video;
- Të kryejë shtrirjen/vendosjen e kabllorë të linjave të telekomunikacionit dhe sinjaleve video;

Matje dhe aparatet matës në elektroteknikë dhe elektronikë

- Të përzgjedhë aparatet e matjes dhe kontrollit sipas madhësi elektrike të kërkuara;
- Të zbatojë metodën e matjeve për qarqe elektrike dhe elektronike;
- Të përdorë aparatet matëse për të bërë matje elektrike dhe elektronike;
- Të llogarisë gabimet që bëhen gjatë matjeve elektrike dhe elektronike;
- Të kryejë matje të parametrave në qarqe të rrymës së vazhduar;
- Të kryejë matje të parametrave në qarqe të rrymës alternative;
- Të kryejë matje të fuqisë elektrike;

Bazat e elektroteknikës

- Të zbatojë ligjet themelore të elektroteknikës gjatë proceseve të punës;
- Të kryejë matje të madhësi kryesore që karakterizojnë rrymën e vazhduar dhe alternative;
- Të ndërtojë qarqet e thjeshta elektrike të rrymës së vazhduar dhe alternative;
- Të ndërtojë qarqet e përbëra të rrymës alternative me elemente elektrike;
- Të llogarisë parametrat e qarqeve të thjeshta dhe të përbëra të rrymës së vazhduar dhe alternative;
- Të llogarisë raportin midis rrymave dhe tensioneve për mënyra të ndryshme lidhjeje yll/trekëndësh dhe anasjelltas;

Bazat e elektronikës

- Të dallojë elementët gjysmëpërcjellës;
- Të ndërtojë skema me element gjysmëpërcjellës;
- Të identifikojë defektet në skema me elementë gjysmëpërcjellës;
- Të llogarisë parametrat bazë të skemave me elementë gjysmëpërcjellës;
- Të ndërtojë qarqe me përforcues;
- Të ndërtojë gjeneratorë elektronik;
- Të realizojë ndërtimin e një burimi fuqie;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta në sisteme të ndryshme numerike;
- Të realizojë qarqe të thjeshta numerike;
- Të dallojë llojet e ndryshme të rjetave të transmetimit;

Makinat eklektike

- Të dallojë makinat elektrike sipas llojit;
- Të kryejë çmontimin dhe montimin e makinave elektrike të ndryshme;
- Të kryejë riparime të thjeshta elektromekanike të pajisjeve dhe makinave elektrike të ndryshme;
- Të kryejë riparime të thjeshta të transformatorëve të vegjël;
- Të montojë skema të thjeshta komandimi të makinave elektrike;

Mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta elektrike dhe elektronike

- Të zbatojë manualët e përdorimit të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike.

- Të përdorë mjetet e përshtatshme për pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike dhe elektronike;
- Të zbatojë teknikat e mirëmbajtjes së pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të zbatojë teknikat e mirëmbajtjes së rrjeteve dhe elementëve përbërës;
- Të identifikojë defekte të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të përdorë mjetet e përshtatshme për riparimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike;
- Të zbatojë teknikat e riparimit të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të kryejë riparime të thjeshta të rrjeteve dhe elementëve përbërës;
- Të realizojë kontrollin fizik të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të zbatojë radhën e çmontimit dhe montimit të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të përdorë teknikat e riparimit dhe të zëvendësimit të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;
- Të testojë pajisjet para, gjatë dhe mbas riparimit;
- Të raportojë në mënyrë të saktë për procesin e mirëmbajtjeve dhe riparimeve të thjeshta elektrike dhe elektronike;

Sigurimi teknik e mbrojtja e mjedisit;

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale në punë;
- Të zbatojë rregulloren e brendshme të biznesit;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të marrë masat e duhura për parandalimin e ndotjes së ambientit në vendin e punës;
- Të përdorë teknikat e dhënies së ndihmës së parë;
- Të respektojë sinjalistikën e sigurisë në punë;
- Të zbatojë procedurat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të klasifikojë dhe depozitojë mbetjet sipas llojit të tyre;
- Të mbajë pastër mjedisin e punës;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejtë, procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.